



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:055163

Datë: 30.07.2024

Numri i dokumentit: 05997296

Ac.nr.3862/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Adnan Konushevc, kryetare e kolegjit, Naime Ahmeti dhe Ylber Shurdhiqi anëtar të kolegjit, me bashkëpunëtoren profesionale Biondina Zeneli, në çështjen juridike-kontestimore të paditësit O.K nga fshati B..... Komuna.Gj....., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson av.M.N nga Gj....., Rr.“Bulevardi i Pavarësisë”, pn, kundër të paditurës Komuna e Gjilanit- Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën me autorizim e përfaqëson B.M, Zyrtar i Lartë Ligjor në Zyrën e Avokatit të Komunës së Gjilanit, me objekt kontesti shpërblimin jubilar, kompensimin e shpenzimeve të ushqimit dhe rrugës, vlera e objektit: 1,818.45, duke vendosur në lidhje me ankesën e të paditurës të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan –Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.1157/2020, i datës 08.04.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 26.07.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e të paditurës Komuna e Gjilanit, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan –Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil C.nr.1157/2020, i datës 08.04.2022, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, C.nr.1157/2020, i datës 08.04.2022 ka vendosur si në vijim:

“I.APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësit O.K nga fshati B.... Komuna e Gj..... dhe DETYROHET e paditura Komuna e Gjilanit-Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit t’ia paguaj edhe atë:

-Në emër të shpërblimit jubilar mbi 20 vite të përvojës së punës shumën prej 229.50 € (dyqind e njëzet e nëntë euro e pesëdhjetë cent), në vlerë prej 75 % të një page bazë (459€);

-Në emër të kompensimit për ushqim për ditët e pranisë në punë (prej datës 18.04.2017 e deri më 20.01.2021) për 695 ditë pune nga 2 €, në ditë përkatësisht shumën 1,390.00€ (njmijë e treqind e nëntëdhjetë euro); dhe

-Në emër të shpenzimeve të udhëtimit për 695 ditë pune (nga 0.70€ në ditë) 70% të biletës së trafikut urban shumë prej 681.10 € (gjashtëqind e tetëdhjetë e një euro);

Gjithsej shumë e përgjithshme prej 2,300,60€ (dymijë e treqind euro e gjashtëdhjetë cent), të gjitha me kamat ligjore prej 8% në vit, nga (data e paraqitjes së padisë 14.04.2020) nën kërcënim të përmbarimit me detyrim deri në pagesën definitive.

II. OBLIGOHET e paditura Komuna e Gjilanit–Drejtoria e Arsimit, që paditësit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës, edhe atë shumë në lartësi prej 270 €, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit më dhunë.”

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka paraqitur përfaqësuesi i autorizuar i të paditurës për shkak të shkëljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që Gjykata e Apelit, ankesën ta aprovojë si të bazuar, ndërsa aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë ta prish dhe çështjen ta kthejë në rigjykim, apo aktgjykimin ta ndryshojë dhe ta refuzojë kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar.

Përgjigje në ankesë nuk ka parashtruar pala paditëse.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa është e pa themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja, përmes të autorizuarit të saj, me datë 14.04.2020 në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi, të precizuar me parashtrësën e datës 01.04.2022, me të cilën ka kërkuar kompensimin e pagave jubilarë, shpenzimeve të ushqimit si dhe të udhëtimit me arsyë si në padi.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas administrimit të provave ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.1157/2020, i datës 08.04.2022 me të cilin e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar gjykata e shkallës së parë ka theksuar se për palët ndërgjygjëse nuk ishte kontestues fakti se paditësja është në marrëdhënie pune te e paditura, për të paditurën nuk ishte kontestuese as lartësia e kërkesëpadisë, mirëpo, si kontestuese për palën e paditur ishte baza juridike e padisë, pasi që e paditura konsideron se nuk është përgjegjëse për përmbushjen e detyrimeve të cilat rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit.

Gjykata e shkallës së parë ka theksuar se ka vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi ashtu që e ka detyruar të paditurën Komuna e Gjilanit -Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit O.K nga fshati B..... tia paguaj „në emër të shpërblimit jubilar mbi 20 vite të përvojës së punës shumë prej 229.50 € (dyqind e njëzet e nëntë euro e pesëdhjetë cent), në vlerë prej 75 % të një page bazë (459€); në emër të kompensimit për ushqim për ditët e pranisë në punë (prej datës 18.04.2017 e deri më 20.01.2021) për 695 ditë pune nga 2 €, në ditë përkatësisht shumë 1,390,00€ (njmijë e treqind e nëntëdhjetë euro); dhe në emër të shpenzimeve të udhëtimit për 695 ditë pune (nga 0.70€ në ditë) 70% të biletës së trafikut urban shumë prej 681.10 € (gjashtëqind e tetëdhjetë e një euro); Gjithsej shumë e përgjithshme prej 2,300,60€ (dymijë e treqind euro e gjashtëdhjetë cent), të gjitha me kamat ligjore prej 8% në vit, nga (data e paraqitjes së padisë 14.04.2020) nën kërcënim të përmbarimit me detyrim deri në pagesën definitive.

Tutje ka theksuar se kërkesat e paditësit bazën ligjore e kanë në nenin 35, paragrafi 5,7 dhe 8, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (*Kontrata nr. 24 e dt. 18.04.2017*) dhe atë sa i përket kompensimeve të rrugës ku është paraparë në nenin 5 ku shprehimisht shkruan “*Punonjëseve arsimorë që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse ku punojnë u paguhen shpenzimet e rrugës 70% të biletave të trafikut urban*”, ndërsa sa i përket kompensimit të ushqimit ku është paraparë në nenin 7 ku, shprehimisht shkruan “*Të punësuarve, u sigurohet kompensimi për ushqim gjatë punës, për ditën e pranisë në punë*” *Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune është dy /2/ € për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi i cili e ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit apo kuzhinës ose në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensimin për ushqim. Ndërkaq sa i përket shpërblimit jubilar në mënyrë shprehimore është paraparë në nenin 8 paragrafi 8.2 e të njëjtës kontratë ku është përcaktuar se: *Punëtorët (anëtarë të SBASHKUT-ut) në vitin jubilar të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit, në vlerë: për 20 vitet e përvojës së punës shpërblimin prej 100% të një page bazë.**

Ndërsa lidhur me pretendimet e të paditurës gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se është e kompetencës lëndore për të gjykuar rastin, pasi që sipas dispozitave ligjore të Ligjit për Gjykatat e Rregullta/ Ligji nr. 06/L – 054 në nenin 12.1 decidivisht është përcaktuar se „*Gjykatat Themelore janë kompetente për të gjykuar në shkallë të parë të gjitha çështjet, përpos nëse me ligj parashihet ndryshe.*” Kurse Departamenti për Çështje Administrative në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë, sipas nenit 17 të Ligjit për Gjykatat gjykon çështjet administrative, respektivisht gjykon sipas padisë për hapjen e konfliktit administrativ, kur kemi një vendim administrativ të formës së prerë ndaj të cilit pala e pakënaqur ushtron padi me qëllim të realizimit të së drejtës së tij subjektive apo kur kemi të bëjmë me heshtje të administratës dhe për kategoritë e punëtorëve që sipas nenit 4 të Ligjit mbi Shërbimin Civil të Kosovës/ Ligji Nr. 03/L-149/ marrëdhënia juridike e të cilëve rregullohet me këtë Ligj, të cilët sipas nenit 82 të Ligjit ndjekin procedurën e realizimit të së drejtës së tyre së pari në Komisionin për Ankesa dhe Parashtrësia, pastaj i drejtohen Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës e më pastaj me padi i drejtohen Gjykatës Themelore në Prishtinë -Departamentit për Çështje Administrative për hapjen e Konfliktit Administrativ, kurse siç dihet të punësuarve në sektorin e arsimit ju garantohet mbrojtje ligjore konform Ligjit të Punës së Kosovës.

Gjykata po ashtu konstaton se e paditura qëndron në detyrimin ndaj paditësit edhe pse nuk është nënshkruese e Kontratës Kolektive të Arsimit/*Kontrata nr.24. e datës 18.04.2017/*, pasi që në nenin 2 të Kontratës është përcaktuar se kjo kontratë është e zbatueshme edhe për komunën apo DKA-të.

Lidhur me pretendimin e të paditurës se paditësi fillimisht nuk i ka shtjerrë mjetet juridike në procedurë administrative para se të paraqes padi në gjykatë, për gjykatën edhe ky pretendim i të paditurës është i pabazuar, për arsye se e drejta e punës është kategori kushtetuese dhe e garantuar me konventat ndërkombëtare dhe me ligj, dhe në rastet e paraqitjes së kërkesës së punonjësit për kompensim dëmi apo në kërkesat e tjera në të holla-para nga marrëdhënia e punës (kërkesat materiale) punonjësi nuk ka nevojë që paraprakisht t’i drejtohet punëdhënësit me kërkesë për mbrojtjen e të drejtave të tij si kusht themelor për parashtrimin e padisë në gjykatë, e në rastin konkret paditësja ka ofruar provën –kërkesën me të cilën dëshmon se ka paraqitur kërkesë te e paditura.

Detyrimi i paditësit për pagesën e kamatës dhe kamatëvonesës prej 8% në vit është gjykuar nga Gjykata konformnenit 382 të LMD/ Ligjinr. 04/L-077 i datës 10 maj 2012, në të cilën dispozitë është përcaktuar se „*Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos*

borxhit kryesor, edhe kamatën. 2. Lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë”.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi ashtuqë e aprovojë si të bazuar kërkesën e paditësit, sa i përket shpenzimeve të procedurës kontestimore, dhe e detyroi të paditurën Komuna e Gjilanit–Drejtoria e Arsimit, që paditësit t’ia paguaj shpenzimet e procedurës, edhe atë: për përpilimin e padisë nga avokati shumë prej 104 euro; për pagesën e taksës gjyqësore shumë prej 31 euro; për përfaqësimin në një seancë gjyqësore shumë prej 135 euro, apo shumë e përgjithshme prej 270€, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit më dhunë.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi juridik i Gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë.

Pretendimet e të paditurës se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2 pika n) sepse dispozitivi i aktgjykimit është kontradiktor me vetveten dhe arsyetimin si dhe i njëjti nuk mund të ekzaminohet nuk qëndrojnë. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Nuk qëndron as pretendimi i të paditurës se kjo kontratë nuk prodhon efekt juridik dhe nuk krijon të drejta dhe detyrime ndaj Komunës së Gjilanit, për shkak se me kontratë kolektive më saktësisht me nenin 46 të saj është përcaktuar se: *“1 . MASHT dhe SBASHK, angazhohen bashkërisht për t’i informuar dhe ndihmuar Komunitat që të bëjnë planifikimin me kohë të buxhetit dhe kostos financiare për zbatimin e dispozitave të nenit 35 paragrafët 5, 7 dhe 9”*, ndërsa me paragrafin 2 të po këtij neni është përcaktuar se: *“2.MASHT dhe SBASHK, angazhohen bashkërisht në Ministrinë e Financave për sigurimin dhe ndarjen e mjeteve financiare për Komunitat e Republikës së Kosovës, me qëllim të realizimit të buxhetit të nevojshëm të përcaktuar në nenit 35 paragrafët 5, 7 dhe 9, brenda mundësive institucionale, ligjore dhe financiare”*, andaj nuk mund të vihet në përfundim se kjo kontratë nuk prodhon efekt juridik për komunitat.

Me nënshkrimin e Kontratës Kolektive nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe përfaqësuesit të paditësve të sektorit të arsimit, Ministria ka marrë obligime në emër dhe llogari të të paditurës, ndërsa obligimi për kompensim bie mbi të paditurën pasi është punëdhënësi i paditësit. Koordinimi ndërmjet nivelit lokal (Komunës) dhe nivelit qendror (Qeverisë–Ministrisë) nuk afekton në të drejtën e paditësit.

Sipas Kontratës Kolektive të Arsimit ekziston një dallim në raport me pagesën e shpërblimeve jubilarë, respektivisht lartësinë e të njëjtave pasi këtu përlllogaritja bëhet me përqindje ku për 10 vite përvojë pune i takon 50 % të një page bazë, pastaj për 20 vite përvojë pune 75% të një page bazë, për 30 vite përvojë pune një pagë bazë dhe për 40 vite përvojë pune 150 % të një page bazë.

Në rastin konkret meqenëse paditësi ka mbi 20 vite përvojë pune, të njëjtit i takon 75% të një page bazë, andaj edhe Gjykata e Apelit e aprovon si të drejtë dhe të ligjshëm vendimin e Gjykatës së shkallës së parë me të cilin e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësve si të bazuar.

E drejta e paditësit gjen mbështetje në nenet: 35.8 të Kontratës Kolektive të Arsimit, me të cilën theksohet se: *“Punëtorët anëtarët e (SBASHKU-të), në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit në vlerë: 8.1, për 10 vjet të përvojës së punës në vlerë të 50% të një page bazë, 8.2, për 20 vjet të përvojës së punës në vlerë të 75% të një page bazë, 8.3, për 30 vjet të përvojës së punës në vlerë të një page bazë, 8.4, për 40 vjet të përvojës së punës në vlerë të 150% të një page bazë, 8.5, Shpërblimi jubilar paguhet nga punëdhënësi, kur i punësuar ka plotësuar kushtet e shpërblimit sipas kriterëve përkatëse, 8.6, shpërblimi jubilar paguhet në rastin e 7 Marsit të çdo viti.*

Gjykata ankimore vlerëson se Gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur në raport me të drejtën për kompensim të shujtave ditore sepse nuk ka qenë kontestues faktin se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura dhe se e njëjta tek e paditura ka realizuar gjithsej 695 ditë pune, andaj, kërkesëpadia e paditësit lidhur me kompensimin e ushqimit gjen mbështetje në nenin 35 paragrafi 7, të Kontratës Kolektive të Arsimit ku theksohet se: *“Të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restaurantit a kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensimin për ushqim”*. Nga ky nen, shihet qartë se paditësit i takon shpërblimi i vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe se Gjykata e shkallës së parë ka vendosur drejt dhe në përputhje me Kontratën Kolektive, lidhur me të drejtën e paditësit për kompensimin e ushqimit për faktin se e paditura ka vepruar në kundërshtim me nenin e sipërcituar.

Përveç kësaj, me Kontratën Kolektive të Arsimit punëtorët kanë të drejtë edhe në shpërblimin e shpenzimeve të rrugës, 70% të biletave të trafikut urban andaj, Gjykata e Apelit e mbështet vendimin e Gjykatës së shkallës së parë edhe për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit, për faktin se paditëses i takon kjo e drejtë konform Kontratës Kolektive të Arsimit, e paraparë me nenin 35 par.5 të kësaj Kontrate, për faktin se është vërtetuar se paditësi udhëton me anë të transportit publik për të shkuar në vendin e tij të punës dhe atë në relacionin Bresalc-Gjilan dhe anasjelltas dhe se çmimi i biletës për këtë relacion është 0,70 cent një drejtim.

Faktin se paditësi udhëton me anë të trafikut publik, Gjykata e vërteton nga vërtetimi i lëshuar nga shoqata e transportit “Anamorava” si dhe certifikata e vendbanimit e paditëses, e të cilat i janë bashkëngjitur shkresave të lëndës si provë, në çmimin prej 0,70 cent, e si rrjedhojë kjo krijon edhe bazën që paditëses ti takojë kompensimi për shpenzimet e udhëtimit ashtu siç përcaktohet edhe me Kontratën Kolektive të Arsimit, më konkretisht me nenin 35 paragrafi 5 i kësaj Kontrate.

Gjykata e Apelit i vlerësoi pretendimet ankimore të paditurës edhe në raport me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, ku e paditura vetëm i ka përmendur ligjet si tërësi duke mos e përcaktuar konkretisht se në çka konsiston shkelja e të drejtës materiale, pra cilat nene të ligjeve konsideron se janë shkelur, sepse kjo Gjykatë vëren se e paditura ka theksuar se Gjykata e shkallës së parë ka shkelur Ligjin për Gjykatat e që për Gjykatën ankimore është e pa logjikshme që ligji në fjalë të jetë shkelur në rastin konkret, sepse në këtë çështje kontestimore kemi të bëjmë me një të drejtë të paditësit që është e garantuar me Kontratë Kolektive, e që Kontratën Kolektive e parasheh Ligji i Punës, ndërsa Ligji për Gjykatat rregullon organizimin, funksionimin dhe juridiksionin e gjykatave në Republikën e Kosovës.

Gjykata ankimore, gjen se meqenëse gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, edhe e drejta materiale është zbatuar drejtë sepse paditësit kompensimin e shumave të aprovuara nga Gjykata e shkallës së parë ia njeh Kontrata Kolektive e Arsimit e që Ligji i Punës më konkretisht neni 90 e parasheh marrëveshjen kolektive, andaj kjo Gjykatë e aprovon në tërësi si të drejtë dhe të ligjshëm vendimin e Gjykatës së shkallës së parë duke vlerësuar se pretendimet ankimore të drejtuara kundër aktgjykimit të atakuar janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla u refuzuan si të pa bazuara.

Vendimi mbi kamatën është marrë konform dispozitave të LMD-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese dhe në pajtim me dispozitat e LPK-së, duke pasur parasysh edhe suksesin e palëve në procedurë.

Gjykata e Apelit i vlerësoi edhe pretendimet e tjera ankimore, por që gjeti se të njëjtat janë irrelevante dhe pa ndikim që kjo Gjykatë të merr vendim ndryshe nga ai sikurse në dispozitiv të aktgjykimi.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195.1 pika d), lidhur me nenin 200, të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.3862/2022 me datë 26.07.2024

Kryetar i kolegjit
Adnan Konushevcu d.v